

Më
Ditë

18 - 06 - 2018

NË EMËR TË POPULLIT

(Handwritten signature)

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal, me gjyqtarin individual Mustaf Tahiri dhe me sekretaren juridike Drita Ujupi, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] komuna Kaçanik, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.1460-5/2016 të datës 29.11.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor fillestar me dt. 03.05.2018, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit shtetit Mimoza Syla, si dhe të pandehurit të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë,

AKT GJYKIM

I akuzuari, [REDACTED], nga fshati [REDACTED] komuna [REDACTED], i lindur më [REDACTED], në të njëtin vend, nga i ati [REDACTED] dhe eëma [REDACTED], pensioner, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal [REDACTED].

ËSHTË FAJTOR

Se me dt.04.07.2016, rreth orës 16:55 në rrugën nga drejtimi i fshatit Komogllavë në drejtim të magistrales Viti – fshati Gërlicë, saktësisht në udhëkryq, derisa ishte duke vozitur me veturën e udhëtarëve e markës "Opel Meriva" ngjyrë hiri me targa [REDACTED], duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 46.1 të LSKRR-së, nga pakujdesia ka vënë në rrezik jetën e njerëzve, në atë mënyrë që duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes para udhëkryqit, gjatë kyqjes duke mos i dhënë përparsi veturës "VW Passat" ngjyrë hiri me targa [REDACTED] që e drejtonte [REDACTED], e cila ishte duke lëvizur në rrugën Viti – Ferizaj duke kaluar në shiritin e tij ku vetura Passat e godet me pjesën e parë në anën e majtë të përparme pastaj vetura "Opell Meriva" del jashtë rruge dhe e godet veturën "Dimler Chrystler" me targa [REDACTED] I të cilën e ka drejtuar [REDACTED] e cila ishte e parkuar jashtë rrugës, me ç'rast përvëç dëmeve materiale kanë pësuar edhe lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme shëndetsore të përshkruara si në ekspertizën mjeko ligjore të dt. 08.09.2017, merr i dëmtuari [REDACTED]

-me këtë ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK,

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së lartë përmendor dhe nen. 4,7,17,23,41,42,43,51,52, dhe 73 të KPK-së dhe nen. 365 të KPPK-së të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Me të cilin e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj dhe në të njëjtën kohë urdhëron që dënimini me burgim të mos ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej 1 /një/ viti pasi ky aktgjykim të merrë formën e prerë nuk do të kryej veprer tjetër penale.

Të dëmtuarit [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] komuna Kaçanik dhe [REDACTED] nga fsh. [REDACTED], komuna Lipjan, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej gjashtëdhjetë euro e tetëdhjetëtë cent (60.88) €, paushallin gjyqësor në shumë prej njëzet (20) €, si dhe shumën prej tridhjetë (30) për programin për kompensimin e viktimate të krimtit në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kanosjen e përmbarimit të detyruar.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP.nr.1460-5/2016 të datës 29.11.2017, e ka ngarkuar të pandehurin [REDACTED] për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga nen 378 par 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Gjkata duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar më dt. 03.05.2018 në të cilin Prokurori i Shtetit Mimoza Syla, në tërsëi mbeti pranë aktakuzës duke i propozuar gjykatës që te pandehurin të shpallë fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I pandehuri [REDACTED], ne shqyrtimin fillestar, me rastin e njoftimit për të drejtën e tij që të pranoj fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenin 246 par.4 të KPPK-së, ka dekluaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilat e ngarkon aktakuza sipas të gjitha pikave, duke shtuar se për këtë aksident e ndien veten keq dhe është penduar, është pensioner dhe i gjendjes së dobët ekonomike, dhe se i kërkoj falje të dëmtuarve për lëndimet që kanë pësuar, duke premtuar që herëve tjera do të jetë ma i kujdeseshëm, andaj ka lutur gjykatën që ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

Me që i pandehuri ka pranuar fajësinë gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së:

- i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit,
- pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri,
- pranimi i fajit mbështetët në faktet e çështjes që përban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i Shtetit, dhe ne provat tjera te cilat gjinden ne

shkresën e lendet siç janë: mendimi dhe konstatimi i ekspertit të mjekësisë ligjore e dt.08.09.2017 me nr.ref.668/2017 nga eksperti mjekësor dr. [REDACTED], si dhe mendimi i ekspertit të komunikacionit ing.dipl. [REDACTED] e datës 16.09.2017, raporti i aksidentit së bashku me përshkrimin e vendit të aksidentit idt.04.08.2016 me nr. 2016-CFI-471, si dhe foto dokumentacioni i cili gjendet ne shkresat e lëndës, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabim faktik.

Meqenëse i pandehuri ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, gjyqtari individual konform nenit 248 par.4 të KPPK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit (*nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik te Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013).*

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarës manifestohen të gjitha elementet e veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga nen. 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK të kryer në mënyrën dhe rrëthanat e përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrëthanat të cilat në kuptim të nenit 73 të KPRK ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata të akuzuarit si rrëhana lehtësuese i mori parasysh pranimin e fajësisë në mënyrë të sinqertë, pendimin e tij të shprehur dhe kërkim faljen ndaj të dëmtuarve dhe keqardhjen për lëndimet që kanë pësuar, moshën dhe shëndetin e tij si dhe rrëthanën se i njejti është pensioner dhe gjendjes se dobët materiale. Ndërsa si rrëhana rënduese gjykata vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të te pandehurit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, andaj mbi bazën e kësaj Gjykata të akuzuarit i shqiptoj një dënim të kushtëzuar duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, rrëthanave të kryerjes së veprës penale, me të cilin dënim do të arrihet qëllimi ndëshkimor në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale.

Gjykata, konform nenit 463 par.2 të KPP-së, të dëmtuarit [REDACTED] nga fsh. [REDACTED], komuna Kaçanik dhe [REDACTED] nga fsh. [REDACTED], komuna Lipjan, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Në bazë të nenit 450 të KPP-së, gjykata të akuzuari e obligoi që të paguaj shpenzimet e procedurës penale për ekspertizën mjeko-ligjore dhe atë të komunikacionit rrugor shumën prej 60.88€, për paushallin gjyqësor në shumë prej 20 €, si dhe konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimtit taksën në shumën prej 30 (tridhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcenim të përbartimit me dhunë.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal
P. nr.2995/17, dt.03.05.2018

Sek.juridike
Drita Ujupi

Gjyqtari individual,
Mustaf Tahiri



KËSHILLA JURIDIKE, Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes të kësaj gjykate.